

Standardi puro Serb me titull *“Rregullore mbi sigurinë e lodrave”*.

Ky standard 24 faqësh, përcakton rregulla mbi sigurinë e lodrave dhe qarkullimin e tyre të lirë në treg, me qëllim sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së jetës dhe shëndetit të njeriut.

Në objektiv është harmonizimi me dispozitat respektive të akteve të BE-së, në fushën e sigurisë së lodrave, në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit .

Afati i fundit për marrjen e komenteve është 14/11/2019.

Ky njoftim realizohet në kuadër të njoftimit të operatorëve ekonomikë që mund të kenë interesa tregtare me shtetin serb lidhur me këtë kategori produktesh, të cilët mund të paraqesin komentet e tyre.